



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve

Data: 26.05.2023

Nr: 153

Ora: 12:15

**VENDIM**

**PËR PRANIMIN PËR SHQYRTIM TË KËRKESËS ANKIMORE NR. 86, DATË 25.05.2023 TË DEPOZITUAR NGA SUBJEKTI ZGJEDHOR "PARTIA LËVIZJA E LEGALITETIT"**

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 26.05.2023, me pjesëmarrjen e:

<b>Elvin</b>	<b>LAKO</b>	-	<b>Relator</b>
<b>Elvis</b>	<b>ÇEFA</b>	-	<b>Anëtar</b>
<b>Ilirjan</b>	<b>RUSMALI</b>	-	<b>Anëtar</b>
<b>Koli</b>	<b>BELE</b>	-	<b>Anëtar</b>

Shqyrtoi çështjen me:

**ANKUES:** Subjekti zgjedhor "Partia Lëvizja e Legalitetit", përfaqësuar nga z. Nazif Sulaj, kandidat për anëtar këshilli bashkiak në bashkinë Kamëz

**OBJEKT:**

1. Kërkesë për ndryshimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultateve për zgjedhjet e këshillit të bashkisë Kamëz, për QV-të nr. 1575/00 dhe QV nr. 1597/02.
2. Kundërshtim i vendimit nr. 536, datë 20.05.2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, "Për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit të zgjedhjeve për Kryetar të Bashkisë dhe për Këshillin e



Bashkisë, në zonën zgjedhore Bashkia Kamëz, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023”.

**BAZË LIGJORE:** Nenet 124, 126, 129 dhe 130 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur,

### **VËREN:**

Subjekti zgjedhor “Partia Lëvizja e Legalitetit” ka depozituar pranë KQZ-së kërkesën ankimore, e cila në respektim të kriterëve të përcaktuara në nenin 127, të Kodit Zgjedhor, është regjistruar në regjistrin e ankimeve zgjedhore, me nr. 86 regj., datë 25.05.2023.

Në mbledhjen e datës 26.05.2023, pas relatimit të z. Elvin Lako u konstatua se kërkesa ankimore nr. 86 i plotësonte elementet e formës të parashikuara në nenin 126 dhe elementet e përcaktuara në nenin 130, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe në mbështetje të nenit 17, pika 3, shkronja “a”, të vendimit nr. 03, datë 06.11.2020, të Komisionit Rregullator “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve”, kërkesa ankimore duhet të kalohet për shqyrtim.

Gjatë seancës paraprake, subjekti zgjedhor “Partia Lëvizja e Legalitetit”, saktësoi objektin duke e cilësuar atë në: *“ndryshimin e rezultateve të Tabelës Përmbledhëse për zgjedhjen e këshillit të bashkisë, bashkia Kamëz”*.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenin 129, pika 3, shkronja “a” të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, KAS-i

## VENDOSI:

1. Pranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nr. 86, datë 25.05.2023, të paraqitur nga subjekti zgjedhor “Partia Lëvizja e Legalitetit”.
2. Shqyrtimi i kërkesës ankimore do të zhvillohet më datë 31.05.2023, ora 15:00.
3. Ngarkohet administrata e KQZ-së me njoftimin e këtij vendimi palëve dhe me zbatimin e tij.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe përfundon me çeljen e seancës së shqyrtimit në themel, sipas shkronjës “b”, të nenit 68 të Kodit të Procedurave Administrative.

<b>Elvin</b>	<b>LAKO</b>	-	<b>Relator</b>
<b>Elvis</b>	<b>ÇEFA</b>	-	<b>Anëtar</b>
<b>Ilirjan</b>	<b>RUSMALI</b>	-	<b>Anëtar</b>
<b>Koli</b>	<b>BELE</b>	-	<b>Anëtar</b>